

VENDIM
Nr. 103, datë 12.5.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” SHPK PËR MARRJEN
E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET KONTRATËS
SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2, germa “a”, 3, 4, gjerat “a” dhe “b”, 5, germa “j”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1590/2 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Construction Energy Parts (C.E.P)’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj”,

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguroese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 mw, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 30.11.2022, për një afat 25-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1590 prot., datë 23.4.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse nëpërmjet hipotekimit në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa “a”, 3, 5, germa “j” dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1

- **germa “a”**: Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj;
- **germa “c”**: Shoqëria duhet të paraqesë informacion mbi gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;
- **germa “d”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve;
- **germa “e”**: Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike;
- **germa “h”**: Shoqëria duhet të depozitojë listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre), e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës së hipotekës që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në

ERE. Gjithashtu në vijim, kërkohet sqarim nga shoqëria “Hydropower” sh.p.k. në lidhje me cilësinë e saj si bashkëkredimarrëse, në funksion të përcaktimeve të kontratës së kredisë;

- **germa “j”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj.

- **Pika 6**: Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t’i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 5466 rep., nr. 1478 kol., datë 23.8.2023, të lidhur ndërmjet palëve.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti